



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
TIRANË

NR. 263 AKTI

NR. 28 VENDIMI

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, në trup gjykues të përbërë nga:

**KASTRIOT SELITA**-----Gjyqtar;  
**ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)**----Gjyqtare;  
**BERNINA KONDI**-----Gjyqtare;

Asistuar prej sekretares [REDACTED] sot më dt. 20/05/2020, pasi mori për shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me nr. 263 me palë:

**PADITËS:** Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

**IPADITUR:** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e vendimit nr. 168, date 18.11.2019 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.  
Pezullimin e ekzekutimit te vendimit nr. 168, date 18.11.2019 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.  
Pagimin e shpenzimeve gjyqesore.

**BAZA LIGJORE:** Neni 32 i Kodit. te Procedures neni. 16 pika 16 e ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi e ne vijim te tij; Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative".

Se me vendimin nr. s'ka, datë 26.12.2019 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës së paditësit Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.
- Shpenzimet gjyqesore siç janë bërë.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 05 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar për palët.

Kunder vendimit ka bërë ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke sjelle keto pretendime ndaj vendimit të gjykatës:

- Pasi u njohëm me vendimin e arsyetur të gjykatës, i cili është dhënë në kundërshtim të ligjit dhe provave të administruara, brenda afatit ligjor 5 ditor, paraqesim pranë gjykatës këtë ankim të veçantë, në lidhje me rrëzimin e kërkesës së paditësit Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për marrjen e masës së sigurimit të padisë.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 168, datë 18.11.2019 të Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, ligjin nr. 49/2012, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga Diskriminimi" duke kërkuar shfuqizimin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 168, datë 18.11.2019 të Komisionerit.
- Nisur nga fakti, se çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe moszbatimi i vendimit të Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në të ardhmen mund të shoqërohet me ndëshkimin e ASHK-së me gjobë nga 30 000 deri në 80 000 lekë. Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së me të drejtë ka kërkuar marrjen e masës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 168, datë 18.11.2019 të Komisionerit. Kjo me qëllim që marrja e masës së përkohshme të sigurimit të padisë "ta mbajë gjendjen ashtu siç është", deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, duke i dhënë garanci palës paditëse që ndaj saj nuk do të merret asnjë masë ndëshkimore, në rastin konkret deri në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel.
- Gjykata në të gjithë arsyetimin e saj, për dhënin e vendimit "rrëzimin e kërkesës së paditësit Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për marrjen e masës së sigurimit të padisë" është bindur vetëm me faktin se, vendimi për marrjen/mosmarrjen e masës së sigurimit të padisë nuk e mbështet në fakte ose veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen në themel të çështjes.
- Gjykata në arsyetimin ka vendosur se nuk jemi në një nga rastet e parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 49/2012.
- Gjykata nuk ka marrë në konsideratë faktin që nëse Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së nuk e ekzekuton vendimin nr. 168, datë 18.11.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi atëherë Komisioneri mund vendosë masë ndëshkimore me gjobë (nenit 33 pika 16 e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"), gjë e cila çënon qëndrueshmërinë financiare të institucionit.

### GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi degjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari kryesues Enkelejda Metaliaj (Softa), referuar akteve bashkëngjitur dosjes Nr. 263, Dt. 10.02.2020 si dhe verifikoi kushtet e pranueshmërisë së ankimit.

### VËREN

Se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e [REDAKTUAR] ish punonjese me kontratë të përkohshme pranë Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të

Paluajtshme. Në përfundim të këtij procedimi administrativ, Komisioneri ka marrë Vendimin nr. 168, date 18.11.2019, me të cilin ka vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, zj. [REDAKTUAR], për shkak të "shtetëzarisë" nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me kërkesën e paraqitur nga znj. [REDAKTUAR] për punësim pranë.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Në referim të nenit 33, të ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", moszbatimi i këtij Vendimi, sjell si pasojë ndëshkimin me gjobe, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kunder këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afiteve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane."

Duke mos u pajtuar me këtë vendim, pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesë padine objekt gjykimi, ku ndër të tjerash ka kërkuar dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.

**Pala paditëse ASHK pretendoi** se Vendimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 168, date 18.11.2019, është marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat e depozituara nga ASHK ja në seancën degjimore, duke tejkaluar kompetencat e percaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Komisioneri ka marrë rolin e punëdhënësit, duke detyruar ASHK të punësojë ankuesen [REDAKTUAR] dhe nëse nuk e zbaton këtë vendim do të ndëshkohet me gjobë (pika 2 dhe 4 e vendimit nr. 08, date 18.11.2019). Komisioneri nuk mund të pretendojë lidhjen e një kontrate të re midis ASHK-se, në cilësinë e punëdhënësit dhe [REDAKTUAR], në cilësinë e punëmarresit, për një punë të njejtë ose ndryshme nga ajo e përshkruar në kontratat e mëparshme të Kontratave të Punës lidhen në përputhje me Vendimet e Bordit Drejtues të ZQRPP-së, sot Keshilli Drejtues i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Vendimi është nxjerre në kundërshtim me qëllimin e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe në mungesë të kompetencës së Komisionarit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi ASHK-ja në asnjë moment nuk e ka diskriminuar apo paragjykuar për shkak të shtetëzarisë apo memesisë znj. [REDAKTUAR] e cila ka patur këtë historik të punësimit të saj pranë palës paditëse ASHK.

Me urdhrin nr. 211, date 21.02.2017 të Kryeregjistruesit, [REDAKTUAR] është emëruar në pozicionin "Specialist" me kontratë të perkohshme pranë Zyres Qendrore të detyrës në Regjistrimin të Pasurive të Paluajtshme, në mbështetje të Vendimit nr. 6, date 06.07.2016, të Bordit Drejtues të ZQRPP-se "Për miratimin e Projektit të Permiresim/Perditesimit dhe Regjistrimit Fillestar për Zonat Urbane dhe Peri-Urbane dhe Organizimin e Shpërndarjes së Punetoreve në funksion të Projektit". Sa më sipër është nënshkruar kontrata individuale e punës (afat të perkohshëm) date 21.02.2017, në pozicionin e specialistit në Projektin e Permiresim/Perditesimit pranë ish-ZQRPP-se, për periudhën 21.02.2017- 31.12.2017, sipas parashikimeve të Kodit të Pmes.

Në mbështetje të Vendimit nr. 3, date 22.12.2017 të Bordit Drejtues të ZQRPP-se "Për Vijimesinë e projektit të Permiresim/Perditesimit dhe Regjistrimit Fillestar për Zonat Urbane dhe

Per-Urbane dhe Organizimin e Shperndarjes se Punctoreve ne funksion te Projektit", vendim i cili ka siguruar vazhdimesine e projektit per vitin 2018. [REDACTED] eshte emeruar perkohesisht ne detyre ne pozicionin Specialiste prane Projektit Permiresim/Perditesimit ne ZQRPP, me urdhrin nr. 1445, date 29.12.2017 te Kryeregjistruesit. Ne zbatim te urdhrin nr. 1445, date 29.12.2017 te Kryeregjistruesit midis ZQRPP-se, si punedhenes dhe [REDACTED] si punemarrese, ne daten 29.12.2017, eshte lidhur Kontrata Individuale e Punes nr. Prot. date 2018, per nje kohezgjatje te caktuar duke filluar na data 03.01.2018-03.07.2018. Kjo kontrate ka përfunduar në fund të kohës së parashikuar në kontratë dhe jo në kohën kur është mësuar për shtatzanine e punemarrëses, e cila ka qene e dukshme edhe para datës 23.04.2018, kur ajo ka depozituar raportin e barrëlindjes. Për të gjitha këto arsye pala paditëse ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.

**Pala e paditur** Komisioneri Per Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka marrë dijeni efektivisht nga fletë-thirrja e datës 24.12.2019. Nisur nga natyra e kërkeses për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe nevoja e saj për shqyrtim brenda afatit 5-ditor. Gjykata bazuar në nenin 28, pika 3, e ligjit nr. 49/2012, ka vendosur shqyrtimin e kesaj kërkesë në mungesë të pales së paditur dhe Avokaturës së Shtetit (kjo e fundit është njoftuar rregullisht me flete-thirrje, por nuk është paraqitur).

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. s'ka, datë 26.12.2019 ka vendosur "Rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë", sipas disponimeve të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke argumentuar ndër të tjera se:

*"Fillimisht, Gjykata analizon se vendimin për marrjen/mosmarrjen e masës së sigurimit të padisë nuk e mbështet në fakte ose veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen në themel të cështjes.(shiko vendimin unifikues nr. 10 date 24.03.2004 të Gjykatës së Lartë). Sa me sipër, Gjykata në vendimin lidhur me masën e sigurimit të kesaj padie nuk merr në shqyrtim dhe as i cmon ato pretendime të pales paditëse që kanë lidhje me themelin e cështjes, të tilla si ligjshmeria apo paligjshmeria e aktit administrativ objekt padie.*

*Pasi degjoi pretendimet e palës paditëse prezent lidhur me kërkesën për sigurimin e padisë, si dhe administroi provat shkresore të paraqitura prej saj, duke i ballafaquar ato me kërkesat ligjore të nenit 29 ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Gjykata arsyeton se ASHK nuk provoi se në rastin konkret ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyesëm dhe të atëçastëm për të, që të justifikojë marrjen e masës së sigurimit të padisë së kërkuar prej saj.*

*Ne momentin e gjykimin të kesaj kërkesë, pala paditëse është lajmëruar për Vendimin nr. 168, date 18.11.2019 të palës së paditur. Asnjë vendim apo veprim tjetër nuk është ndermarre nga pala e paditur në ngarkim të ASHK, as edhe gjoha e permendur në pikën 4 të vendimit. Gjohitja e ASHK përbën një event të ardhshëm dhe jo aktual, në kuptim të nenit 29 të ligjit nr. 49/2012. Prej palës paditëse nuk u pretendua dhe as u provua një veprim tjetër që ka cenuar aktualisht një interes ligjor të saj dhe që i ka shkaktuar asaj një dëm të rëndë, të pakthyesëm dhe aktual për të.*

*Edhe pse është një kusht kryesor për marrjen e masës së sigurimit të padisë, nuk u provua para Gjykatës se dëmi që do t'i shkaktonte pala paditëse prej vazhdimin të ekzekutimit të vendimit*

*objekt padie, ishte i rende, i pakthyeshem, i atecatshem. Ne rast se ky akt administrativ do te vlerësohet si i marre ne kundërshtim me ligjin, Gjykata cmon se cdo pale e demtuar nga veprimet apo aktet e paligjshme të organeve te administrates publike, ka të drejten e zhdemimit sipas nenit 44 te Kushtetutes.*

*Sa më sipër, Gjykata arrin ne përfundimin se kërkesa e palës paditese ASHK për marrjen e masës së sigurimit te padisë, pezullimin e ekzekutimit te vendimit nr. 168, date 18.11.2019 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, duhet rrëzuar si e pabazuar ne ligj e prova.”*

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit.**

Ky kolegji vlerëson se në analizë të provave, shpjegimeve të palëve, shkaqeve të ngritura në ankim nga pala paditur dhe ligjit të aplikueshëm në rastin konkret, cmon se vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë është rrjedhojë zbatimit të ligjit procedural dhe material e për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi.

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara në kërkesë dhe të akteve bashkëngjitur saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës Administrative të Apelit vlerëson se për t'u shprehur lidhur me kërkimin në fjalë është e domosdoshme të bëhet një analizë e kriterëve të parashikuara në nenet 28, 29 e 30, të ligjit nr. 49/2012, lidhur me kushtet për sigurimin e padisë dhe llojet e masave për sigurimin e padisë.

Konstatohet se ligji në fjale në nenet 28-33 të tij ka parashikuar institutin e sigurimit të padisë, duke përcaktuar me imtësi paraqitjen e kërkesës për sigurimin e padisë, shqyrtimin e kësaj kërkesë, kushtet për sigurimin e padisë, llojet e masave të sigurimit të padisë, ankimi, etj

Neni 28, parashikon: “Sigurimi i padisë”:

1. Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ.

2. Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia.

3. Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të ngutshme mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët.

4. Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia.

Neni 29 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikon: "Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;

b) nuk çënohet rëndë interesi publik;

c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Neni 30 i ligjit nr. 49/ 2012 parashikon: "Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet":

a) Pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ;

b) Marrjen edhe të masave të tjera të përshtatshme nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme.

Pala paditëse mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë kur ajo tregon se ekzekutimi i aktit objekt kundërshtimi gjyqësor gjatë kohës që vazhdon gjykimi i çështjes, mund të sjellë dëm të rëndë e të pariparueshëm. Për vendosjen e masave të sigurimit gjykata duhet të vlerësojë detyrimisht ekzistencën e njëhershme të këtyre kushteve:

- dyshimin e arsyeshëm e të bazuar në shkresa lidhur me mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë;

- dëmi i rëndë të jetë për paditësin i pakthyeshëm;

- dëmi i rëndë duhet të jetë i atëçastshëm;

- duhet të ruhet interesi publik nga çënimi i rëndë.

- garancinë nga paditësi lidhur me dëmin që mund t'i vijë palës së paditur nga sigurimi i padisë (kriter ky që është lënë nga legjislatori në vlerësim të gjykatës).

Pas vlerësimit të kriterëve të mësipërme, gjykata mund të vendosë si masë sigurimi pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ që kundërshtohet dhe në rast se një masë e tillë nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme, gjykata mund të vendosë edhe masa të tjera të përshtatshme krahas asaj të pezullimit.

Në rastin në shqyrtim, referuar pretendimeve të palës paditëse, si dhe akteve shkrësore bashkëngjitur kërkesës, konstatohet se në kërkesë pretendohet dëmi i pariparueshëm nga zbatimi i aktit administrativ të vendimit nr. 168, date 18.11.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke treguar demin konkret që të mund të vlerësohet nga gjykata nëse perben ose jo dem të rëndë.

Është pikërisht ky fakt i cili duhet të provohet nga pala paditëse pra mundësia e shkakimit të dëmit dhe faktin se dëmi i shkakuar do të jetë i konsiderueshëm. Fakti i mësipërm merr rëndësi për më tepër për të analizuar nëse ky dem është apo jo i riparueshëm për palën paditëse.

Veç sa më sipër, masa e sigurimit të padisë duhet të jetë në proporcion me kërkimet që do të përbëjnë themelin e kërkesë padisë dhe të sigurojë mbrojtjen efektive të objektit të kërimit të përcaktuar në kërkesë padie.

Referuar akteve në dosje, ka rezultuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e [REDAKTUAR] ish punonjese me kontrate të perkohshme pranë Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në përfundim të këtij procedimi administrativ, Komisioneri ka marrë Vendimin nr. 168, datë 18.11.2019, me të cilin ka vendosur: "1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, zj. [REDAKTUAR] për shkak të "shtatezanisë", nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. 2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me kërkesën e paraqitur nga znj. [REDAKTUAR] për punësim pranë. 3. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", brenda 30 (tridhjetë) diteve nga marrja e vendimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij. 4. Në referim të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", moszbatimi i këtij Vendimi, sjell si pasojë ndeshkimin me gjohje, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni. 5. Kunder këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda afiteve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë."

Pala paditëse, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka kërkuar pezullimin e zbatimit të aktit administrativ atë të vendosjes së gjohës në të ardhmen nëse kjo e fundit nuk do të marrë sërish në marrëdhënie pune ish punëonjësen [REDAKTUAR]

Po kështu, provohet fakti se nëpërmjet vendimit të mësipërm Komisioneri për Diskriminimin (ka karakter rekomandues), ka kërkuar që pala paditëse të marrë masa për ndreqjen e pasojave në të ardhmen të cilat mund të jenë dhe konflikt gjyqësor aktualisht që do të thotë se palës paditëse nuk mund t'i vijë një dëm i rëndë, i atëçastshëm e mbi të gjitha pariparueshëm dhe për më tepër nuk jemi përpara faktit se kemi cënim të interesit publik.

Pezullimi i ekzekutimit është marrja e masës së perkohshme të sigurimit të padisë, që në vetvete ka për qëllim "ta mbajë gjendjen ashtu sic është", pra të "ngrirë". Në kushtet që kërkesa e palës paditëse konsiston në faktin për ndreqjen e pasojave në të ardhmen të cilat mund të jenë dhe konflikt gjyqësor, Kolegji vlerëson se nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 28,29,30 i ligjit 49/2012 i ndryshuar.

Përfundimisht, Gjykata Administrative e Apelit, mbi bazën e kësaj situatë ligjore dhe faktike, i vlerëson të papërligjura pretendimet e ngritura në lidhje me kërkesën për sigurimin e padisë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në Nenin 50/b të Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

### **VENDOSI**

- Lënien në fuqi të vendimit nr. s'ka, datë 26.12.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall sot më datë 20.05.2020. Tiranë.

**GJYQTARE**  
**BERNINA KONDI**  
*d.v*

**GJYQTARE**  
**ENKELEJDA METALIAJ(SOFTA)**  
*d.v*

**GJYQTAR**  
**KASTRIOT SELITA**  
*d.v*

*Vërtetohet njësia me origjinalin*

*Kancelari*  
*Leonid Stratij*  
*Stratij*